




**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOVOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644 – 18 – 3685 – 1-3-6/C69  
14 Nr. 482/18  
Dt. 21.06.2018

## KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj – Drejtoreshë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) , dhe
2. **Grupi I Op. Ek. “ InterAdria “L.L.C.** me seli në Prishtinë , me NRB : 70875209 dhe Nr. Fiskal : 600910807 dhe NT “ Interadria “ me NRB: 80249080 E Nr.F.: 600011712 , si Operatorë Ekonomik, të cilët i përfaqëson : **Shkumbin Kajtazi**, në tekstin e mëtejme: **FURNITORI/KRYESI I SHËRBIMIT**

. janë pajtuar të lidhin këtë kontrate publike, për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon:

Furnizimi, montimi dhe instalimi i kabllit optik për lidhjen e objekteve të administrates dhe atyre shëndetësore me objektin e ri të komunës, me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	8	36	8	5	1	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	8	0	6	5	1	3	6

### Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon :  
**Furnizimi, montimi dhe instalimi i kabllit optic për lidhjen e objekteve të administrates dhe atyre shëndetësore me objektin e ri të komunës, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : 644-18-065-136.**

### Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim dhe ekzekutim të shërbimeve do të jetë jo më gjatë se **10 ditë kalendarike** nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës. Duke qenë se Autoriteti Kontraktues respektivisht stafi i administratës komunale është në fazën kur duhet kaluar në objektin e ri të komunës, me qëllim që mos të ndërpritet funksionalitetit i shërbimeve ndaj qytetarëve, disa shërbime të parapara në përshkrimin teknik duhen të ekzekutohen pas kalimit të stafit administrativ në objektin e ri të komunës, për të cilat punë dhe ose shërbime Kontraktuesi paraprakisht do të konsultohet me Menaxherin e Kontratës të Autoritetit Kontraktues.

- 2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit dhe / ose ekzekutimit të shërbimeve do të jetë si vijon : objektet e administratës komunale, objekti i QKMF-re dhe objekte tjera sipas përshkrimit teknik, pjesë e Dosjes së Tenderit.
- 2.3 Garancioni për cilësinë e paisjeve do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit/ Kryesit të Shërbimeve. Afati i garancionit fillon nga data e pranim – dorëzimit të pajisjeve dhe përfundon në një afat prej minimum 12 muajve.

### Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **1.291,99€( njëmijdyqindnëntdhjetenjë/99€)**.
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do të nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.
- 3.3 Pagesat do të bëhen pas Pranimit të pajisjeve nga ana e Komisionit për Pranim të Autoritetit Kontraktues.

### Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **shqipe**<sup>1</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

<sup>1</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

<b>Emri:</b>	Saranda Cakaj
<b>Pozita:</b>	Drejtoreshë për Prokurim Publik
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	21.06.2018
<b>Vula:</b>	



**Për Kontraktuesin - Furnizuesin:**

<b>Emri:</b>	Shkumbin Kajtazi
<b>Pozita:</b>	Përfaqësues i : Gr.OE: “ InterAdria “L.L.C. & NT “ Interadria “ – Prishinë
<b>Nënshkrimi:</b>	per: <i>Kajtazi</i>
<b>Data:</b>	21.06.2018
<b>Vula:</b>	




Numri i prokurimit: VU644-18-065-136 apo Brendshem644-18-065-136 Titulli: Furnizimi, montimi dhe instalimi i kabullit optik për lidhjen e objekteve të administratës dhe shëndetësore me objektin e ri të komunës

**Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G**


Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8 apo 18, e jo në formatin 0%,8%apo48%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH.

Çmimi duhet të shkruhet me dy decimale pas presjesë dhjetore, në të kundërtën nuk do të meerrret per bazë numri i tret pasë presjes

Nr.	Përshkrimi i Artikujve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
1	Lidhja në rret me fibër optik të Aneks objektit (Drejtoria e kadastrit dhe Drejtoria e urbanizmit) me Objektin e ri të Komunës								
2	Furnizimi dhe vendosja e Fibrës Optik single mode ADSS SM 4 fije me standart për instalim të jashtëm dhe me elementet për ndërlidhje që nevojiten për të bërë funksional. (shtrirja e kabllit duhet të behet një pjesë jashtë neper ajër dhe një pjesë në sistemin nëntokësor)	m'	450	0.89	18	1.05	400.50	72.09	472.59
3	Media Converter Fiber to RJ45 simplex 100/100 MB	Copë	2	81.77	18	96.49	163.54	29.44	192.98



4	Furnizimi dhe montimi i kutise shperndarëse IP65 per vendosje te paisjeve me elemente lidhese	Copë	1	26.00	18	30.68	26.00	4.68	30.68
5	Pg tela SC 2m	Copë	2	1.53	18	1.81	3.06	0.55	3.61
6	Spllajsimi dhe matja me OTDR (certifikimi) duke perfshire edhe spjallsimin e kablilit ekzitues te QKMF I cili do te lidhet ne objektin e kadastrit	Copë	4	5.51	18	6.50	22.04	3.97	26.01
7	Furnizim dhe vendosja e kablilit te rrjetit CAT6 (2 koneksione 40m dhe 4 koneksione 10 m) dhe vendosja e 5 m kanal te plastikes	m'	80	0.55	18	0.65	44.00	7.92	51.92
2	Shtrirja e kablilit optik nga Objekti i ri Komunës deri te puseta shpërndarëse për të lidhur në rrjet objektet shëndetësore								
9	Furnizimi dhe vendosja e Fibrës Optik single mode ADSS SM 12 fije me standart per instalim te jashtem dhe me elementet për ndërildhje qe nevojiten per te bere funksional.	m'	120	1.00	18	1.18	120.00	21.60	141.60
10	Furnizimi dhe montimi Xhutes per instalim te jashtem per 96 koneksione	Copë	1	57.42	18	67.76	57.42	10.34	67.76
11	Spllajsimi dhe matja me OTDR (certifikimi)	Copë	36	5.51	18	6.50	198.36	35.70	234.06
12	Furnizim Pach panel per fiber single mode 12 port	Copë	1	38.80	18	45.78	38.80	6.98	45.78



NUMRI I PROJEKTIUT: V0044-10-000-100 apo DREJTUSHTIMOR44-10-000-100 I TITULLI: Furnizimi, montimi dhe instalimi i kabllit optik per lianjen e objekteve te administrates dhe shendetesore me objektin e ri te komunës

13	Montimi i rack	Copë	1	21.19	18	25.00	21.19	3.81	25.00
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH:</b>							<b>1,094.91</b>	<b>197.08</b>	<b>1,291.99</b>



<b>IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)</b>	
<b>EMRI I OE:</b>	Konzorciumi InterAdria L.L.C. & NT InterAdria
<b>EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:</b>	Shkumbin Kajtazi
<b>NËNSHKRIMI:</b>	
<b>DATA:</b>	04.06.2018
<b>VULA:</b>	